

VENDIM
Nr. 119, datë 6.3.2024

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION DHE NDËRTIM I RRUGËVE ‘KSANTHIPI ZYKO’ DHE ‘ABDYL YPI’, BASHKIA DURRËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion dhe ndërtim i rrugëve ‘Ksanthipi Zyko’ dhe ‘Abdyl Ypi’, Bashkia Durrës”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Durrës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 9 241 113.3 (nëntë milionë e dyqind e dyzet e një mijë e njëqind e trembëdhjetë pikë tre) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 9 241 113.3 (nëntë milionë e dyqind e dyzet e një mijë e njëqind e trembëdhjetë pikë tre) lekësh përballohet nga Bashkia Durrës.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Durrës.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Durrës.

8. Bashkia Durrës kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Durrës.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Durrës, për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Durrës, për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Durrës, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “RIKONSTRUKSION DHE NDËRTIM I RRUGËVE ‘KSANTHIPI ZYKO’ DHE ‘ABDYL YPI’, BASHKIA Durrës”

No.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)							VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM						Vlera totale/tekl	Shënimet (kuftizime hipotekare, barri mbi pasuritë, etj.)
											TRUALL			NDËRTESË				
	Emër	Aktiva	Mblenës	Fshati/qyteti	Z. kadastrale	No. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale/m²	Trruall/m²	Ndërtesa/m²	Sipërfaqja/m²	Çmimi (tekl./m²)	Vlera/tekl	Sipërfaqja/m²	Çmimi (tekl./m²)	Vlera/tekl		
1	Albert	Hasan	Ahuzaj	Durrës	8513	2/927	Trruall	509	509	260	220	12,945	2,847,900	0	0	0	2,847,900	Konfirmuar nga ASHK-ja.
2	Hasan		Abazi	Durrës	8513	2/929/ND	Ndërtesë	20	0	20	0	0	0	20.00	67,500	1,350,000	1,350,000	Konfirmuar nga ASHK-ja, E- Kjo ndërtesë ndodhet mbi pasuritë nr. 2/645 vol. 38 fq. 245.D- e vlefshme veçim për të mundësuar blerjen e trruall. Pasuria nr. 2/645, sipas kartelës së pasurisë është në pronësi shtet.
3	Nisarije		Falli	Durrës	8513	2/643	Trruall	134,94	134,94	59	76	12,945	983,043.3	59	67,500	3,982,500	4,965,543.3	Konfirmuar nga ASHK-ja, vlihet nr 14/L në fshat të Fondeit Beas me k. ligj nr. 1778/486/4 datë 26.6.2018. Sipas shërbimit nr. 101/1 pres., datë 17.1.2024, të Bashkisë Durrës, kërkesa i fonde të shpërndarimit do të qëndrojë e ngurtë deri në shpërndarim e barrit hipotekare me vendim Gjykatë të formës së prerë.
4	Lavdim		Bulla	Durrës	8513	2/997	Trruall	103	103	52	6	12,945	77,670	0	0	0	77,670	Konfirmuar nga ASHK-ja.
	Drita	Musa	Bulla															
	VLERA TOTALE												3,908,613.3			5,332,500	9,241,113.3	